




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-0/DPK
Nr. i faq Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	01-4589/12
Data Datum Date	24.12.2012



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 12.12.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllët rasti më nr. AKK–03-3718\12, për zyrtarin e lartë z. Arsim Haxhiu, Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Kuvendin Komunal të Drenasit, për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej, pasi që ka dëshmuar se i ka bërë ndryshimet e kërkuara nga Agjencia dhe nuk ushtron më funksion udhëheqës në biznesin e tij privat.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës së marrë, ka filluar shqyrtimi i lëndes me numër protokolli AKK–03-3718/12, që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z. Arsim Haxhiu, Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Kuvendin Komunal të Drenasit .

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Kuvendin Komunal të Drenasit, ka qenë i regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve ARBK, si person i autorizuar dhe pronar në biznesin N.SH. Ambulanca Speciali stike “Interistika” e që sipas Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 06.11.2012, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit

të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave me datën 12.11.2012, z. Arsim Haxhiu, Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Kuvendin Komunal të Drenasit, është ardhur në takim në zyrat e AKK-së, dhe na ka njoftuar se e ka marrë shkresën njoftuese dhe dëshiron të njoftohet më detal për situatën që dyshohet për Konflikt të mundshëm të Interesit.

Gjatë takimit e kemi njoftuar për situatën që gjendet z. Haxhiu, ku edhe ai vet është pajtuar por kemi marrë zotimin se do të shfrytëzoj të gjitha mundësitë dhe në afatin ligjor do të bëjë ndryshimet e kërkuara në biznesin privat dhe nuk do të menaxhoj me atë biznes.

Me datën 07.12.2012, z. Arsim Haxhiu ka sjellë në Agjenci dëshminë lëshuar nga ARBK-ja se nuk ushtron me pozitë udhëheqëse në biznes por ka mbetur vetëm si pronarë, ndërsa e ka emëruar një person që gjatë kohës sa ushtron funksion publik të menaxhoj me Biznesin e tij.

Andaj në bazë të dëshmive dhe fakteve konstatohet se :

Zyrtari i lartë, z. Arsim Haxhiu, Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Kuvendin Komunal të Drenasit, nuk gjendet me në situatën e përshkruar si Konflikt të mundshëm të Interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik pasi që nuk ushtron me pozitë e menaxherit në biznesin privat pasi që ka emëruar si person të autorizuar një menaxher për ta udhëhequr biznesin.

Kjo situatë ka paraqitur mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik si Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Kuvendin Komunal të Drenasit, dhe pozitës së tij në biznesin privatë N..SH. Ambulanca Specialiste "Interistika".

Konstatohet se pas ndryshimeve që janë bërë dhe gjendjes faktike tash, z. Arsim Haxhiu, Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Kuvendin Komunal të Drenasit, nuk gjendet në situatën e Konfliktit të Interesit.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

